



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rosi Trade" Sh.P.K. të datës 04.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rosi Trade" Sh.P.K. të datës 04.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Rosi Trade" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Në dosjen e tenderit në FDT, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar: Autokran me gjatësi 35 m per pasrim të dritareve dhe fasadave të jashtme. Ne vlerësojm se kërkesa e till nuk është e përshtatëshme për aktivitetin me titull: Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale, autokrani është i destinuar kryesisht për kompanit e ndertimit dhe të ngjajshme sepse i njëti sherben për dergimin e materialeve në distanca të larta. Sipas përvojës sone dhe kërkesave të tenderve të ndryshem për pastrim të objekteve kërkohën Kamion me Korp, e njëjta është edhe teknikisht e përshtatëshme në ofrimin e sherbimeve të pastrimin në distancë si xhamave dhe fasave. Ne komunikim me disa operatorë që ofrojnë krane me qera na është thënë se kërkesa në distanc prej 35 metrave për Kamion me korp është kërkesë e lartë dhe jashtë standartit në treg ka kamion në distanc 34 dhe 36 metra. Ne kerkom që ta zëvendësoni emertimin e kësaj kërkesa në vend të Autokran me gjatësi 35 metra në Kamion me korp në 34 metra psh".

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesës për kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

Autokran me gjatësi 35 m per pasrim të dritareve dhe fasadave të jashtme

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se cili autokran me gjatësi min. 34 m e realizon funksionin e njëjtë për faktin që nuk ekzistojnë objekte mbi 34 m që duhet pastruar. Së këndejmi vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik". Prandaj AK do të korrigjoj kërkesën e DT si vijon "Autokran me gjatësi min. 34 m per pasrim të dritareve dhe fasadave të jashtme".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net